



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**A nr. 1237/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Valbona Thaçi Bajçinca kandidate për anëtare të kuvendit komunal nga radha e LDK-së në Fushë Kosovë, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të manipulimit të votave, për Zgjedhjet Lokale në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

### **VENDIM**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Valbona Thaçi Bajçinca, kandidate për anëtare të kuvendit komunal në Fushë Kosovë, nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK).

### **Arsyetim**

Me datën 03.12.2013 në ora 15:50, Valbona Thaçi Bajçinca kandidate për anëtare të kuvendit komunal nga radha e LDK-së në Fushë Kosovë ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën ankesë pretendohet se rezultatet që janë publikuar nga QNR-ja nuk përputhen për kandidatet për asamblë komunale në Fushë Kosovë nga LDK, ku Arjeta Jashari sipas publikimeve të rezultateve në QNR ka 69 vota, ndërsa ajo posedon vetëm 66 vota, thuhet në pretendimet e ankuesit. Parashtruesi i ankesë nuk ka bashkangjitur asnjë dëshmi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi ankesën gjeti se:

### **ankesa është e pabazuar**

PZAP-i, konstatoi nga shkresat e lëndës se pretendimet ankimore të kandidates për anëtare të kuvendit komunal Valbona Thaçi Bajçinca nga radha e LDK-së, janë të pa argumentuara në prova dhe dëshmi bindse pasi që ankesës në fjalë nuk i ka bashkangjitur asnjë dëshmi apo provë, për të vërtetuar shkeljen e supozuar, andaj ankesa vlerësohet si e pa bazë, duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr. 1237/2013 më datën 06.12.2013.



***Këshillë Juridike:*** Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.